

KOMPETENCAT DHE DETYRAT

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

IKTK-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e IKTK-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Në përputhje me Vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "*Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit*", Drejtori i Përgjithshëm i IKTK emërohet, lirohet dhe/ose shkarkohet nga detyra, nga Ministri i Kulturës, në rast se dispozita të tjera, të veçanta, ligjore dhe nënligjore, nuk parashikojnë ndryshe.

Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së është punonjës i nivelit të lartë drejtues, përgjegjës kryesor për mbarëvajtjen e punës në IKTK. Koordinon punën me strukturat që ka në varësi, dhe me njësitë organizative në ministri.

Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së është kryetar i Këshillit Teknik dhe sekretar i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik

Drejtor i Drejtorisë është punonjës i nivelit të mesëm drejtues dhe është përgjegjës kryesor për mbarëvajtjen e punës në drejtorinë përkatëse. Koordinon punën me strukturat që ka në varësi: përgjegjës sektori dhe specialist.

Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik (DSHA) e ushtron veprimtarinë e saj në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

Drejtoria ka nën varësinë e saj funksionale sektorët si më poshtë:

- a) Sektori i Shpëtimit Arkeologjik Nëntokësor dhe Nénujor;
- b) Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Arkeologjike Nëntokësore dhe Nénujore

Vendimarrja është rutinë, brenda udhëzimeve dhe/ose procedurave ligjore.

Drejtor i Drejtorisë së Monumenteve të Kulturës

Drejtor i Drejtorisë është punonjës i nivelit të mesëm drejtues dhe është përgjegjës kryesor për mbarëvajtjen e punës në drejtorinë përkatëse. Koordinon punën me strukturat që ka në varësi: përgjegjës sektori dhe specialist.

Drejtoria e Monumenteve të Kulturës e ushtron veprimtarinë e saj në fushën e trashëgimisë kulturore materiale me qëllim gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.

Drejtoria ka nën varësinë e saj funksionale sektorët si më poshtë:

- a) Sektori i Veprave të Artit;
- b) Sektori i Arkitekturës Antiko Mesjetare;
- c) Sektori i Qendrave Historike, Arkitektura e Traditës dhe Peizazhit;
- d) Sektori i Qendrës Rajonale të Konservimit dhe Restaurimit për Evropën Juglindore.

Vendimarrja është rutinë, brenda udhëzimeve dhe/ose procedurave ligjore.